# DËSHMI ARKIVI

**A-454555**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kundërshton PD/ Dekretimi i ligjit për magjistratët, Kaso sulmon presidentin: Begaj për hir të mazhorancës heq dorë me qejf nga kompetencat e tij |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/18/kundershton-pd-dekretimi-i-ligjit-per-magjistratet-kaso-sulmon-presidentin-begaj-per-hir-te-mazhorances-heq-dore-me-qejf-nga-kompetencat-e-tij654656/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 09:46:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 18 shtator 2026, 09:43:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 18 shtator 2026, 09:42:00 UTC → 18 shtator 2026, 09:44:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d22be21f7d11f06e5fd81e02f2fdfa8ee700d802b6146ff85ab7180a47d9ce6c` |
| TEKSTI | `3fec89d3a4cfc77a54043331151d59c43cf6c07dac85449f181ac61f3f63a798` |
| PAMJA | `c3dd266dff9c733de5e071a9cc1da5bbb9c70e47e86fcf9152512d2c0290086e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `beae39ef7a177a700934e4d50572803b920ac6002b90f258f803cb24151495ba` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/beae39ef7a177a700934e4d50572803b920ac6002b90f258f803cb24151495ba`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KRYESORE POLITIKË TË FUNDIT

# Kundërshton PD/ Dekretimi i ligjit për magjistratët, Kaso sulmon presidentin: Begaj për hir të mazhorancës heq dorë me qejf nga kompetencat e tij

18/09/2026 11:43



**Pas dekretimit nga Presidenti Bajram Begaj të ligjit që parashikon zhbllokimin e pagave të magjistratëve nëpërmjet formulës së re me një rritje prej 8500 lekësh të reja, ka ardhur reagimi i parë nga Partia Demokratike.**

Deputeti Ivi Kaso ka kritikuar vendimin e Kreut të Shtetit, duke ngritur pikëpyetje mbi dhënien paraprake të pëlqimit për hyrjen e menjëhershme në fuqi të ligjit dhe duke e lidhur këtë veprim me mënyrën se si mazhoranca ka trajtuar çështjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kaso tha se ky dekretim nuk i shërben interesit publik dhe se, sipas tij, magjistratët nuk rrezikonin të mbeteshin pa paga.

"Nuk më çudit lajmi që mora dje në seancë, nga goja e një deputeti të mazhorancës, që Presidenti kishte dhënë pëlqimin paraprak për hyrjen menjëherë në fuqi të ligjit, në një kohë që edhe kolegët e mazhorancës nuk ishin të qartë se çfarë drafti po debatonin lidhur me pagat e magjistratëve.

Kujtojmë që ka pasur një iniciativë të dy deputetëve të mazhorancës, në kundërshtim me atë që kishte përcaktuar Gjykata Kushtetuese. Pasi do të duhej të ishte, në radhë të parë, qeveria që, nëpërmjet Kuvendit, të adresonte një mekanizëm të ri ligjor.

Po tutje kësaj, për shkak të dy amendamenteve që u paraqitën në Komisionin e Ligjeve, ishin vetë kolegët e mazhorancës të paqartë se për çfarë po debatonin dhe çfarë duhej të miratohej.

Ndërkohë që morëm vesh që Presidenti e kishte dhënë paraprakisht pëlqimin, kjo për të ilustruar faktin që, sigurisht, një President që ka demonstruar që, sa herë interesi i mazhorancës e kërkon, heq dorë me qejf nga ato prerogativa të pakta që, për hir të së vërtetës kushtetuese, i kanë ngelur. Kjo sigurisht nuk i bën nder një institucioni kaq të lartë.

Ky dekretim i menjëhershëm si i shërben interesit publik? Nuk është se gjatë kësaj periudhe magjistratët do të rrinin pa paga", u shpreh Kaso.

**Top Channel**

## Kryesore »







## Kryesore



**Presidenti Begaj dekreton ligjin për formulën e re të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve**
10:44

**Debat Rama-Tabaku në Kuvend, deputetja e PD: Dorëhiqu, zbato kërkesën e qytetarëve. Kryeministri: Opozita që përzihet nga protesta quhet 'amanet mushkat, se kuajt ikën'**
08:24

**Lojëra fati dhe kanabis në një lokal, arrestohet 47-vjeçari në Malësinë e Madhe**
08:54

**El Niño dhe ngrohja globale/ Më shumë nxehtësi, më shumë lagështi, avujt e ujit arrijnë nivel rekord në atmosferë**
07:13

**Basketbolli në zi, ndahet nga jeta në moshën 43-vjeçare ish-ylli i NBA**
10:54

## Më të lexuarat

**Kryeministri Rama viziton Malin Athos në Greqi, qëndron gjatë natës në Manastirin e Vatopedisë**

**Dënimi me 81 vite i ish-liderëve të UÇK-së, Grenell në Top Story: Kosova s'ka nevojë që vendimet t'i marrë një gjykatë në Holandë, duhet të vendosë vetë**

**"Vendimi nga Haga është pozitiv për Kosovën", deklarata e studiuesit Spahiu shkakton debat në Top Story, Rakipllari: Je gëzuar ti më shumë se Vuçiç**

**Deputetja e PDK tregon në Top Story prapaskenat e largimit të spiunëve nga Kosova, Musliu: Në 2015-ën u mbushën autobusët, gënjyen edhe për...**

**Arrestohet Kastriot Hasko, ortaku i Bedinajt te prona në konflikt me Luan Muçën në Palasë, akuzohet për falsifikimin e 1143 hektarëve në Fier**

**Hashim Thaçi reagon për herë të parë pas dënimit me 25 vite burg nga Gjykata në Hagë: Mohoj çdo përfshirje në vrasje, do ta apeloj vendimin**

**'JO NË EMRIN TIM!', Taulant Xhaka shpërthen pas Hagës, reagimi i tij tërbon mediat serbe**

**Miratohet me 84 vota ligji i maxhorancës që rrit me 2% rrogat e magjistratëve, Rama**



Top Channel/ Makina përfshihet nga flakët, panik te qytetarët pranë parkimit nëntokësor në Fier



Top Channel/ Bardhi: Të pakorruptuarës i dolën dy vila, Balluku fle në Drimadhes apo Palasë?



Top Channel/ CDU, gati të braktisë Merz? Cfare ndodh të dielën!

**Lajme**
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

**Bota**
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

**Sport**
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

**Pop News**
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

**Programe**
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

**Top Channel**
- Rreth Top Channel
- Topin e kam unë – Apliko tani!
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.